



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 953/3 Prot.

Tiranë, më 29.03 2024

V E N D I M Q A R K U L L U E S

Nr. 17 datë 29.03 2024

“PËR  
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE E  
ANALITIKE TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS”

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UST-së neni 43, gërma II), në VKM me nr. 243, datë 20.04.2023 “Për një ndryshim në VKM nr.748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtim me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë”, të ndryshuar, në Udhëzimin e MASR nr.29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.07, datë 01.02.2023 “Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2023”, në shkresën e Ministrisë Arsimit dhe Sportit me nr 144/1 prot datë 16.02.2024 “Njoftim për rregjistrim dhe numrin e rregjistrimit për Titull akademik”Profesor i Asociuar”, në shkresën e Ministrisë Arsimit dhe Sportit me nr 233/1 prot datë 09.03.2024 “Njoftim për rregjistrim dhe numrin e rregjistrimit për Titull akademik”Profesor i Asociuar, në shkresën e Ministrisë Arsimit dhe Sportit me nr 234/1 prot datë 12.03.2024 “Njoftim për rregjistrim dhe numrin e rregjistrimit për Titull akademik”Profesor i Asociuar”, në Vendimin e Rektoratit nr.16 datë 27.02.2024, si dhe në Vendimin e Rektoratit me nr.20 datë 20.03.2024 “Për disa ndryshime në strukturën organizative e analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 22 datë 20.03.2024 “Për disa ndryshime në strukturën organizative e analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Bordi i Administrimit në Vendimin Qarkullues,

V E N D O S I :

1. Miratimin dhe ndryshimin e strukturës organizative dhe analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës, si më poshtë:
  - **Z.Elton Defrim Spahiu**, Drejtues i Departamentit të Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizimit, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, me gradë shkencore “Doktor” kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar”. Efektet financiare fillojnë me miratimin e KPPA me datë 05.02.2024, dhe në vazhdim.

- **Z.Dritan Refat Sallaku**, Personel akademik pranë Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, me gradë shkencore “Doktor” kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar”.Efektet financiare fillojnë me miratimin e KPPA me datë 01.03.2024, dhe në vazhdim.
  
  - **Z.Sead Mehmet Bushati**, Personel akademik pranë Departamentit të Sporteve Individuale në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes me gradë shkencore “Doktor”, kalon me titullin akademik “Profesor i Asociuar” . Efektet financiare fillojnë me miratimin e KPPA me datë 01.03.2024, dhe në vazhdim.
2. Pagesa e **Z.Elton Defrim Spahiu**, do jetë sipas VKM me nr.243, datë 20.04.2023 “Për një ndryshim në Vendimin nr.748, datë 11.06.2009, të Këshillit të Ministrave, për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, të ndryshuar, Lidhja nr.1,Nr. Rendor 7, Pozicioni Përgjegjës i njësisë bazë me tituj “Profesor i Asociuar”.
  
  3. PAGESA E **Z.Dritan Refat Sallaku dhe Z. Sead Mehmet Bushati**, do jetë sipas VKM me nr.243, datë 20.04.2023 “Për një ndryshim në Vendimin nr.748, datë 11.06.2009, të Këshillit të Ministrave, për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, të ndryshuar, Lidhja nr.1,Nr. Rendor 12, Pozicioni /kategoria “Profesor i Asociuar”
  
  4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori, Njësitë kryesore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
  
  5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek transparenca universitare.

**KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**Artur ÇOBANI**

